



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL Anr.1137/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Faton Ademi dhe Adnan Konushevci anëtar, si dhe me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Arjeta Sylja, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) me seli në Prishtinë, dega në Istog, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Prishtinë, dega në Istog, për shkak të parregullsive në ditën e votimit për Rivotim në Komunën e Istogut e mbajtura me datë 17.12.2017, për Kryetar të Komunës së Istogut, në seancën e panelit të mbajtur, me datë 19.12.2017, mori këtë:

## V E N D I M

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e parashtruar nga subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) me seli në Prishtinë, dega në Istog, me shenjë ZL.Anr.1137/2017, e datës 18.12.2017, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Prishtinë, dega në Istog, për shkak të parregullsive në ditën e votimit për Rivotim, në Zgjedhjet Lokale të mbajtura me datë 17.12.2017, për Kryetar të Komunës së Istogut.

## A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 18.12.2017, ka pranuar një ankesë nga subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) me seli në Prishtinë, dega në Istog, me të cilën ka pretenduar se në qendrën e votimi 0601C/07C, janë vërejtur parregullsi ku edhe procesi nuk është nënshkruar nga të gjithë komisionerët dhe deklaratat e vëzhgueseve dhe koordinorit, deklaratat e lexueshme për keqpërdorimet që kanë ndodhur gjendet në kutinë e votimit. Ankesës i ka bashkangjitur dy deklaratat të komisionereve në atë vendvotim dhe një kopje të printuar të Formularit të Përputhjes së të Dhënave dhe Rezultateve (FPR).

PZAP-i, pas shqyrtimit të bazueshmërisë dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

### **Ankesa është e pabazuar**

Paneli pas ekzaminimit të ankesës në fjalë ka konstatuar se ankesa është e përgjithësuar pasi ankuesi vetëm ka kërkuar hapjen e kutisë së votimit 0601C/07C por nuk e ka specifikuar se pas hapjes së kutisë në fjalë cila është kërkesa e tij për rinumërim apo rivotim. Rrjedhimisht

ankesa si e tillë përveç se është e përgjithësuar e njëjta po ashtu është edhe jo e plotë sepse nuk ka prova të mjaftueshme për të mbështetur pretendimet që rrjedhin nga ankesa.

Ankuesi si provë të vetme ka dorëzuar dy deklarata të dy komisionerëve: Endrit Bujupaj dhe Rudina Shoshi.

Komisioneri Endrit Bujupaj ka deklaruar se nga personat të cilët janë lejuar të votojnë edhe pse të njëjtit kanë pasur ngjyrë në gishtërinjë është kërcënuar, mirëpo i njëjti nuk ka ofruar prova se rastin e ka paraqitur në polici.

Po ashtu ky komisioner pretendon se personat në fjalë të cilët janë lejuar që të votojnë janë familjar të kryesuesit të vendvotimit, por për të njëjtit nuk ka ofruar prova: së paku emrat dhe mbiemrat e tyre për të vërtetuar këto pretendime. Meqenëse ankuesi pretendimet e tij nuk arriti ti mbështes në prova bindëse dhe të qarta paneli vlerëson se nuk ka bazë për të aprovuar ankesën në fjalë.

Komisionerja tjetër Rudina Shoshi në deklaratën e saj ka deklaruar se ka pasur persona që janë lejuar të votojnë edhe pse të njëjtit kanë pasur sprej ngjyrë në duar, ndërsa më tutje shtoi se vërejtjet janë evidentuar në libër nga ana e komisionerit të VV, ndërsa kryesuesi ka ndërhyrë në shkrimin e ankesës së komisionerit të VV.


Paneli gjatë hetimit në librin e votimit dhe në formularin e përputhjes së të dhënave dhe rezultateve ka konstatuar se formulari është nënshkruar nga të gjithë anëtarët me përjashtim të anëtarit nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosja Endrit Bujupaj, i cili ka deklaruar se nuk dëshiron të nënshkruaj pa dhënë arsye tjera. Në librin e votimit nuk ka ndërhyrje të theksuar me përjashtim të një fjale në faqen 6 rreshti i III-të, është rregulluar, por se e njëjta nuk ia humb kuptimin e fjalisë dhe se nuk bëhet falë për ndërhyrje të tilla siç ka pretenduar anëtari i LVV-së, dhe tani që pretendon ankuesi në ankesë. Po ashtu personat që janë lejuar të votojnë sipas librit të votimit është e vërtetë se kanë pasur sprej apo ngjyrë në duar sepse ashtu është evidentuar mirëpo të njëjtit nuk kanë pasur sprej në gishtin tregues të dorës, në të cilin bëhet identifikimi i votuesit se a ka votuar dhe njëkohësisht në të cilin gisht bëhet spërkatja gjatë procesit të votimit. Siç konstatohet nga libri i votimit, votuesit i është identifikuar spreji në shuplakën e dorës. Për më tepër paneli vlerëson se identifikimi me llamb ulravjollcë për ta siguruar procesin e votimit duke kontrolluar votuesin se a ka votuar nëpërmes spërkatjes së sprejit nuk është e vetmja mënyrë e identifikimit të votuesit se a ka votuar apo nuk ka votuar por është njëra nga mënyrat e identifikimit, sepse votuesi identifikohet edhe përmes letërnjoftimit si dhe identifikohet edhe nëpërmes nënshkrimit të tij në librin përfundimtare të votuesve.

Paneli ankesën e konsideron si të përgjithësuar dhe të pa argumentuar me fakte dhe si të tillë jo bindës pasi që nuk i plotësoj kërkesat ligjore të përcaktuara me dispozitën e nenit 117 i Ligjit nr. 03/-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. Rrjedhimisht PZAP-i në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse për pretendimet e paraqitura në ankesë, konstaton se ankesa në fjalë është e pabazuar dhe e pa argumentuar dhe si të tillë e refuzoj.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
ZL.Anr.1137/2017 më datë 19.12.2017

**Kryesuesi i Panelit**  
**Fejzullah Rexhepi**



*Udhëzim Juridike:* PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelime, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*